




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN



VENDIM

Nr.5, datë 24.03.2022

PËR

KORRIGJIMIN E KOORDINATAVE DHE MIRATIMIN E RINOVIMIT TËLEJES "PËR PËRDORIM TËBURIMIT UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË AMBALAZHUAR (ME BOT) ME NR. 218/1 PORT., DATË 21.03.2017 MIRATUAR ME VENDIM NR.7 DATË 16.02.2017 NGA KBU SEMAN", DHËNË NË FAVOR TË SUBJEKTIT "KOND"

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

V E N D O S I:

1. Korrigjimin e koordinatave të lejes nr.218/1 prot.datë 21.03.2017 miratuar me vendim nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Seman si më poshtë
Vendndodhja e pus shpimit (KRGJSH)

Nga: X=484742.5; Y= 4522483.7; Z= 22 m.m.n.d.

Në : X=484622.7; Y= 4523342.3; Z= 17 m.m.n.d.

Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=0.5l/s

2. Miratimin e kërkesës për rinovimine lejes nr.218/1 prot., datë 21.03.2017 për “Përdorim burimi ujqor nëntokësor për ujë të amballazhuar (tregtim me bot)”.

Vendndodhja e pus shpimit (KRGJSH)

Në : X=484622.7; Y= 4523342.3; Z= 17 m.m.n.d.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

